



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1063 Prot.

Tiranë, më datë 18.11.2020

VENDIM

Nr. 402, datë 18.11.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të raporteve të vëzhgimit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.11.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e raporteve të vëzhgimit arkeologjik në kuadër të procesit të rindërtimit për 11 zona si në vijim: Bubq; Nj.A. Golem, Nj. A. Kavajë; Universiteti Bujqësor i Tiranës, Zona Kombinat, Nj. A. Zona Autotraktori, 5 Maji, Krujë, Shijak zona 4 Durrës dhe zona 2 Lezhë, të realizuara nga B.O. “Met Engineering” sh.p.k, Z. Taulant Rama dhe Z. Skënder Muçaj;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Elva MARGARITI

SEKRETAR

Arta DOLLANI

Arta
Dollani

Digitally signed by Arta Dollani
DN: cn=Arta Dollani,
o=Ministria e Kulturës,
ou=Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale,
c=AL

Elva
Margariti

Digitally signed
by Elva Margariti
Date: 2020.11.18
19:01:13 +01'00'